

**VENDIM**  
**Nr.719, datë 20.10.2011**  
**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE**  
**TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS , SARANDË<sup>1</sup>**

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shkrihen e Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë, e krijuar me vendimin nr.152, datë 8.4.1992 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.

2. Krijimin e *Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës si institucion publik me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.*

3. *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës drejtohet nga drejtori, i cili emërohet nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.*

4. Rekrutimi i punonjësve të *Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.

5. *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ka për mision përmbushjen e të gjitha shërbimeve të nevojshme shtetërore që lidhen me menaxhimin e infrastrukturës dhe të dhënave të peshkimit e të akuakulturës, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në mbrojtjen e peshkimit dhe akuakulturës në Republikën e Shqipërisë.*

*Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës kryen këto detyra:*

*a) menaxhon infrastrukturën e peshkimit, përfshirë portet dhe qendrat e peshkimit;*

*b) grumbullon të dhënat e peshkimit;*

*c) harton programet e ripopullimit të kategorive ujore;*

*ç) menaxhon qendrën dhe impiantet e midhjes në Sarandë;*

*d) menaxhon ekonomitë e rasateve të peshkut në Zvezdë, Korçë, të rasateve të koranit në Lin, Pogradec, dhe ekonomitë e tjera të rasateve të peshkut;*

*dh) garanton respektimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së peshkimit dhe akuakulturës nëpërmjet monitorimit dhe inspektimit të veprimtarisë së peshkimit. Monitorimi dhe inspektimi i veprimtarisë së peshkimit kryhen nga sektori i monitorimit dhe i kontrollit të peshkimit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.*

6. *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës harton rregulloren e vet të funksionimit, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përkrahjet e vendit të punës së çdo*

---

<sup>1</sup> Vendimi nr.719, datë 20.10.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.152/2011  
VKM nr.1068, datë 14.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.207/2013  
VKM nr.44, datë 29.1.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.10/2014

funkzioni në këtë drejtori. Rregullorja miratohet nga *Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

7. Veprimtaria e *Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* financohet nga *buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

8. Struktura dhe organika e kësaj drejtorie miratohen me urdhër të Kryeministrit, *me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen e procedurave në QKR, për çregjistrimin si person juridik të Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë.

10. Ngarkohen *Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave* dhe *Ministria e Financave* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
SALI BERISHA**